



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.187, datë 07.05.2021

PËR  
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E  
APELIT TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE,  
TË SHPALLUR ME VENDIM NR.184 , DATË 28.05.2020,  
PËR KANDIDATEN ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 07.05.2021, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidates për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, si dhe propozimin për përfundimin e kësaj procedure për kandidaten znj. {...},

VËREN

**I. TË DHËNA PËR PROCEDURËN DHE KËRKESËN E KANDIDATIT**

1. Me Vendimin nr. 174, datë 28.05.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale...”*

2. Me Vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, Këshilli ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale...”*

3. Me Vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, Këshilli ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale...”*

4. Në të tria këto procedura të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Durrës, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 29.05.2020, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 15.06.2020.

5. Brenda afatit të kandidimit për të trija këto pozicione të lira ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier e komanduar ne skemën e delegimit pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

6. Me Vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, Këshilli ka vendosur:

*“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.173, nr.174, nr.176, nr.179, nr.180, nr.181, nr.182, nr.183, nr.184, nr.185, nr.186, nr.187 dhe nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...12. Për kandidaten znj. {...}-relator z. Alban Toro; ...”*

7. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidaten znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me Vendimin nr.282, datë 08.09.2020, vendosi:

*“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimin e Këshillit nr. 174, dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 184, nr. 185, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*

*2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimin e Këshillit nr. 174, dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për*

*pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 184, nr. 185, datë 28.05.2020”.*

8. Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidaten znj. {...}, në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës, të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli me Vendimin nr. 170, datë 22.04.2021, ka vendosur:

*1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 174 nr. 184, nr. 185, datë 28.05.2020.*

*2. Vendimi nr. 282, datë 08.09.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.*

*3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.*

9. Përveç sa sipër, Këshilli, në Mbledhjen Plenare të datës 01.04.2021 vendosi rihapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallura me Vendimet nr. 117 - 120<sup>1</sup>. Afati i kandidimit për këto pozicione të lira u përcaktua “*deri në datë 16.04.2021*”.

10. Brenda afatit të kandidimit për këto pozicione të lira, me datë 16.04.2021, me kërkesën nr. 1608 prot., protokolluar në Këshill, kandidoi edhe kandidatja znj. {...}, konkretisht për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 120 datë 01.04.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

---

<sup>1</sup> Vendimi nr. 117, datë 01.04.2021, “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Vendimi nr. 118, datë 01.04.2021, “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Vendimi nr. 119, datë 01.04.2021, “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Vendimi nr. 120, datë 01.04.2021, “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

11. Në rastin e kandidimit të fundit, kandidatja znj. {...} rikonsideroi kandidimet e saj, duke përcaktuar tre pozicionet për të cilat do të vijonte kandidimin, duke theksuar në kërkesën e parashtruar se tërhiqej nga kandidimi për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 184 datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor duke vijuar kandidimin për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 174 datë 28.05.2020, nr. 185 datë 28.05.2020 dhe nr. 120 datë 01.04.2021.

12. Në rrethanat sa sipër, bazuar në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), ku përcaktohet se: *“Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”*.

## **II. KONKLUZIONE**

13. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidatja znj. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e saj për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 184, datë 28.05.2020, Këshilli i lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidatë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e relatorit të çështjes,

### **VENDOSI:**

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**